

Regullore

Per reflektimin e Transaksioneve nga Qendra e Regjistrimit të Aksioneve - Sh.A.

Rregullorja e Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve - Sh.A.. është hartuar mbi bazën dhe në përputhje të plotë me legjislacionin e mëposhtëm:

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë
Kodi i Proçedurës Civile të Republikës së Shqipërisë
Ligji për Noterinë
Ligji për Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare
Ligji për Titujt

SEKSIONI 1

PERKUFIZIME - PROÇEDURAT E ZAKONSHME

1.01 Aksioni. Aksion quhet titulli i pronësisë në një shoqëri aksionare, pra, njëra prej pjesëve të barabarta në të cilat ndahet kapitali themeltar i shoqërisë dhe që i jep pronarit të aksionit të drejtën e votës dhe të pjesmarrjes në shpërndarjen e fitimit në formën e dividendit në një masë proporcionale me vlerën e aksioneve të tij.

1.02 Dividenti. Divident quhet pjesa e fitimit neto të shoqërisë që i ndahet aksionerëve.

1.03 Transaksioni. Do të quhet akti i transferimit të pronësisë mbi aksionet, me apo pa shpërblim.

1.04 Transaksioni midis individëve. Kryerja e një transaksioni midis dy individëve, që veprojnë në emër dhe për llogari të tyre mund të realizohet:

(a) me paraqitjen fizike të të interesuarëve tek Regjistrari.

Kur dy persona bien dakord që të kryejnë një transaksion mund të paraqiten fizikisht tek Regjistrari duke qënë të pajisur me dokumentat përkatëse të identifikimit, si karte identiteti, pashaporte biometrike dhe ne raste te caktuara te shoqeruara me certificate lindje.

ose

(b) pa paraqitjen fizike të të interesuarëve tek Regjistrari.

Kur dy persona bien dakord që të kryejnë një transaksion, por nuk paraqiten fizikisht tek Regjistrari për ta realizuar atë, këtij të fundit duhet t'i dërgohen këto dokumenta:

(i) Kontrate noteriale per transferimin e pronësisë mbi aksionet, te redaktuar nga noteri(qofte kjo me shpërblim ose pa shpërblim);

(ii) Prokurat e perfaqesimit qe autorizon kryerjen e ketij transaksioni; dhe

(iii) pagesa apo vërtetimi i pagesës në favor të Regjistrarit për shërbimin që ky i fundit do të kryejë.

Koment:Per kryerjen e procedurave te regjistrimit te transaksionit midis paleve kontraktore kerkohet qe te jen respektuar dispozitat ne lidhje me redaktimin e akteve noteriale, - neni 39 a); nenet 43,44,45,46 dhe kryesisht neni 49 te Ligjit „Per Noterine“ dhe nuk do te pranohen akte private, qe permbajne lidhje kontrate ose kryerjen e veprimeve te tjera juridike me vertetim nenshkrimi te kryer nga noteri, pasi ky verpim noterial eshte i pavlefshem sipas nenit 55 te Ligjit „Per Noterine“ theksohet se vertetimi i nenshkrimave behet per akte private, qe nuk permbajne lidhjen e nje kontrate ose kryerjen e nje veprimi tjetër juridik.

Pagesa për Regjistrarin mund të bëhet me anë të instrumentave bankarë ose ne arken e Regjistrarit.

1.05 Transaksioni për të njëjtin aksion. Nqs Regjistrarit i paraqiten dy transaksione te lidhura si akte noteriale, duke qene te redaktuara nga noteri, të të njëjtit aksion për dy blerës të ndryshëm, atëhere:

(a) kur transaksionet paraqiten njëkohësisht, Regjistrari do të quajë të vlefshëm atë që ka datë më të vonshme vetëm në rastet:

(i) kur blerësi i transaksionit me datë më të hershme heq dorë nga blerja me anë të një deklarate noteriale te perpiluar ne perputhje me ligjin „Per Noterine“.Ne kete rast do te konsiderohet si revokim kontrate nga te dy palet kontratore, qofte nga shitesi i cili duke lidhur kontraten e dYTE te shitjes do te konsiderohet se ka revokuar transaksionin e pare, qofte nga ana e bleresit i cili duke hequr dore nga transaksioni i pare, ben te mundur te mos prodhoje asnje efekt juridik.

Në të gjitha rastet e tjera quhet i vlefshëm transaksioni që ka datë më të hershme.

(b) kur transaksionet nuk paraqiten njëkohësisht, Regjistrari do të quajë të vlefshëm atë që vjen i pari, pavarësisht nga data.

Koment: Kontrata e shitjes se aksioneve (apo ne pergjithesi cdo lloj transaksioni me aksionet e nje shoqerie aksionare qe Ligji „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“ dhe ligji „Per Titujt“ e detyron qe Regjistrin e aksioneve ta mbaje ne Qendren e Regjistrimit te Aksioneve sh.a.) konsiderohet kontrate formale e cila prodhon efekte vetem pas kalimit te aksioneve nga njera llogari ne tjetren (nga shitesi tek bleresi), prane Regjistrarit.Per kete arsye, cdo kontrate translative pronesia me date me te hershme do te preferohet perpara asaj me date te mevonshme, kur transaksionet mbi te njejtin aksion paraqiten njekohesisht dhe ne rast se ato paraqiten ne data te ndryshme perparesi do te kete ai transaksion qe eshte paraqitur me pare prane „Qendres se Regjistrimit te Aksioneve“ sh.a. per te kryer kalimin, pavarësisht nga data e kryerjes se veprimit juridik.

1.06 Nënshkrimi i vërtetuar. Me nënshkrim te vertetuar te nje transaksioni, ne kete rregullore do te kuptojme:

Çdo transaksion qe kryhet me pranine fizike te paleve kontratore perpara Regjistrarit vertetohet sipas procedurave te brendshme operuese me nënshkrimin e vertetuar te paleve nga vet Regjistrari;ndersa ne rast se palet nuk paraqiten personalisht, atehere do te kerkohe vetem transaksioni i kryer si akt noterial (duke qene i redaktuar nga noteri sipas ligjit „Per Noterine“ neni 39 a),43-46&49-50).

Ky rregull nuk zbatohet vetem ne rastin kur informacioni per rregjistrim transaksioni, „Qendres se Regjistrimit te Aksioneve“ sh.a. i vjen nga institucione shtetore ose financiare, sic jane Agjensia Kombetare e Privatizimit ose Bursa e Tiranës, (me te cilen ekzistojne detyrime reciproke per reflektim transaksioni ne baze te marreveshjes se nënshkruar midis te dyja paleve), si dhe institucione te tjera qe Regjistrari i pranon si vertetues nënshkrimesh.

1.07 Forma e nënshkrimit të vërtetuar. Nënshkrimi i vërtetuar duhet të jetë i formës:

EMRI MBIEMRI (FIRMA)

i shkruajtur i gjithi me shkrim dore nga nënshkruesi dhe i ndjekur nga firma.

Koment: Për kushtet aktuale, nënshkrimi i personit do të vërtetohet vetëm duke u paraqitur fizikisht ky i fundit përpara vërtetuesit.

1.08 Nënshkrimi me shenjë . Individu që merr pjesë në transaksion, i cili nuk është i aftë të shkruajë emrin e tij mund të nënshkruajë me një shenjë (X) (nënshkrim i vërtetuar) dhe ky nënshkrim të vërtetohet nga Regjistri, në prani edhe të një personi të tretë, i cili nënshkruan gjithashtu.

Vërtetuesi detyrohet të shpjegojë me shkrim të gjithë procedurën e mësipërme duke pohuar që në prani të tij, individit iu shpjegua se për çfarë po e vënte shenjen, efektet ligjore të veprimit juridik dhe se personi ishte dakort për këto gjë.

1.09 Institucionet financiare. Me institucione financiare do të kuptojmë të gjitha institucionet shtetërore dhe financiare, si Agjencia Kombëtare e Privatizimit, Bursa e Tiranës, si dhe institucione të tjera financiare, që Regjistri i pranon si vërtetues nënshkrimesh dhe mbi bazën e informacionit të dhënë prej tyre në lidhje me kryerjen e transaksioneve, operon me reflektimin e tyre në regjistrin e aksioneve të Emetuesit.

1.10 Vërtetimi nga Institucionet financiare të falimentuar apo të thithur. Nënshkrimi i vërtetuar nga një institucion financiar për të cilin Regjistri e di apo ka arsye të besojë se ka falimentuar, është thithur, bashkuar apo është shpëputur nga biznesi nuk do të pranohet.

1.11 Korrigjimet dhe ndryshimet. Çdo korrigjim apo ndryshim në transaksion duhet të vërtetohet nga vërtetuesi.

1.12 Mospërgjegjësia e Regjistrarit. Këto rregulla e lehtësojnë Regjistrarin nga përgjegjësia ligjore e kryerjes së një transaksioni të gabuar si rezultat i mos pasjes mundësi nga ana e tij për të kontrolluar:

(a) pretendimet mbi pronësinë e aksionit; dhe

(b) zotërimin e fuqisë ligjore, në momentin e kryerjes së transaksionit, nga ana e personit që po e kryen atë.

1.13 Fiduçarët (Personat e besuar). Fiduarët janë persona që zotërojnë fuqinë ligjore për të vepruar në emër dhe për llogari të një personi tjetër. Fiduarë do të quhen ekzekutorët, administratorët, përfaqësuesit me prokurë të noterizuar, kujdestarët sipas legjislacionit në fuqi, likuidatorët, administratorët e falimentimit.

1.14 Vërtetimi i cilësisë së fiduarit . Për të vërtetuar cilësinë e tij si fiduar ky i fundit duhet të paraqesë:

(a) kur është caktuar me vendim të gjykatës duhet të paraqesë për kryerjen e transaksionit Vendimin e Gjykatës se formës së prerë, që e cakton si përfaqësues të disponuesit të aksioneve.

(b) kur nuk është caktuar me vendim gjykatë, atëherë nga ana e Regjistrarit do të kërkohej akti noterial, që e përcakton personin si përfaqësues apo fiduar të aksionerit disponues, në emër dhe për llogari të të cilit vepron në këto transaksion; si dhe në qoftë se akti noterial apo dokumenti është leshuar prej një kohe me të gjatë se 60 ditë, atëherë në rast se do të shikohet e arsyeshme, mund të kërkohej edhe një vërtetim nga noteri, që prokuruar apo akti noterial i leshuar është ende në fuqi, pasi nuk ka mbaruar sipas normave ligjore në fuqi.

Koment: Zoterimi i prokures nga ana e përfaqësuesit prezumon vazhdimin e prodhimit të efekteve juridike të prokures, pavarësisht se ka kaluar afati i përcaktuar me sipër prej 60 ditësh. Megjithatë Regjistri mund të refuzojë regjistrimin e transaksionit në rast se e shikon të arsyeshme dhe mund të kërkojë çdo lloj shkrese apo dokument tjetër që të vërtetojë cilësinë e përfaqësuesit (neni 74&76 K.C.)

1.15 Verifikimi i dokumentit. Kur dokumenti është:

(a) vendim gjykate duhet të ketë formën e zakonshme të një vendimi me nënshkrimin e gjyqtarit dhe vulën e gjykatës. Në rast se vendimi është i shkurtuar, autenticiteti i tij vërtetohet nga sekretaria e gjykatës; ose

(b) jo vendim gjykate duhet të vërtetohet që:

(i) është një kopje e vërtetë dhe e plotë e origjinalit,

(ii) origjinali nuk ka ndryshuar dhe është zbatuar siç duhet nga personi i duhur, dhe

(iii) personi i duhur ka fuqinë juridike për të vepruar në atë moment

1.16 Evidentimi i vdekjes. Vdekja e aksionerit vërtetohet nëpërmjet njërit nga dokumentat e mëposhtëm:

(a) vendimi i gjykates per çeljen e trashgimise

1.17 Përgjegjësia e Regjistrarit. Regjistrari mban përgjegjësi për një transferim të gabuar, pavarësisht nga rregulli i pikës 1.12 në rastet kur:

(a) merr njoftim me shkrim ose vërtetohet që ka dijeni që fiduçitari nuk e gëzon më këtë cilësi në kohën dhe mënyrën që i japin mundësi të pezullojë kryerjen e transaksionit;

(b) merr njoftim me shkrim për një pretendim mbi pronësinë e aksionit

(i) në kohën dhe mënyrën që t'i japë mundësi Regjistruarit të pezullojë kryerjen e transaksionit; dhe

(ii) njoftimi duhet të përmbajë:

(1) emrin e pretenduesit,

(2) emrin e pronarit të regjistruar,

(3) emrin e emetuesit të aksionit,

(4) adresën e pretenduesit;

(c) merr njoftim me shkrim ose vërtetohet që ka dijeni që kryerësi i transaksionit e ka humbur zotësinë juridike për të vepruar në kohën dhe mënyrën që i japin mundësi të pezullojë kryerjen e transaksionit;

(d) ka vepruar me keqbesim.

1.18 Besueshmëria e pretendimit. Nqs Regjistrari merr njoftim për një pretendim pronësinë apo për pavlefshmërinë e cilësisë së fiduçarit, duke ju referuar pikës 1.12, ai do ta shkarkojë përgjegjësinë për të kontrolluar këtë pretendim, duke njoftuar pretenduesin që transaksioni do të kryhet nqs brënda 30 ditëve nga ky njoftim, Regjistrari:

(a) nuk merr një njoftim nga gjykata për pezullimin e kryerjes së transaksionit; ose

(b) pretenduesi nuk lë një peng të mjaftueshëm për mbulimin e humbjeve të Regjistrarit nga moskryerja e transaksionit.

Koment: Kontrata e pengut duhet të bëhet me akt noterial duke specifikuar si kreditor Regjistruesin.

1.19 Njoftimi për pezullimin e transaksionit. Njoftimi për pezullimin e transaksionit duhet të bëhet me shkrim ose me gojë nqs ky i fundit ndiqet nga një konfirmim me shkrim brënda tre ditë pune.

Koment: Njoftimi për pezullimin e transaksionit do të njihet vetëm nqs bëhet nga pronari i regjistruar, ose nga personat që Regjistrari i njeh si përgjegjës apo të autorizuar për të kryer këtë veprim. Regjistrari duhet të marrë parasysh çfarë duhet bërë, në rast se njoftimi për pezullimin e transaksionit kryhet nga persona të tjerë.

Regjistrari mund të anulojë pezullimin dhe të njoftojë të gjithë palët e interesuara në këtë transaksion, kur kjo gjë kërkohet nga personi që ka bërë njoftimin për pezullim ose me vendim gjykate.

1.20 Proçedura e pezullimit të transaksionit.

(a) Kur Regjistrari merr njoftimin për pezullimin e transaksionit duhet:

- (i) të shënojë gjëndjen e bllokimit në llogarinë e pronarit të aksionit, dhe
- (ii) të njoftojë të gjithë palët e interesuara

(b) Kur Regjistrari i kërkohet të kryejë transaksion mbi një llogari të bllokuar duhet:

- (i) të veprojë njëllonj si për rastin e njoftimit për pretendim, dhe
- (ii) të njoftojë personin që ka dhënë urdhërin e bllokimit që duhet të veprojë sipas paragrafit 1.18 pikat (a) dhe (b).

1.21 Kufizimet në kryerjen e transaksionit. Nqs kërkohet të kryhet një transaksion mbi aksione për të cilat Emetuesi ka vënë kufizim, Regjistruesi nuk proçedon me transaksionin por i kërkon Emetuesit mënyrën se si duhet të veprojë.

1.22 Pagesa e dividendit në cash ose e interesave. Urdhëri për pagimin e dividendit në cash apo interesave një personi tjetër që nuk është pronari i regjistruar i aksionit, panvarësisht nëse ai mund të jetë kryerës i transaksionit, duhet të bëhet me shkrim dhe me nënshkrim të vërtetuar.

Koment: Nqs dividenti paguhet në aksione shtesë, këto aksione do të regjistrohen gjithmonë në emër të pronarit të regjistruar dhe asnjëherë në emrin e personit, i cili sipas pikës 1.22, mund të jetë përfituesi i dividendit në cash.

SEKSIONI 2

KRYERJA E TRANSAKSIONEVE PER RASTIN E SHOQERIVE

2.01 Transaksionet për rastin e Shoqërive Aksionare.

Për kryerjen e transaksionit kërkohet:

(a) aprovimi i Administrarorit, i cili është i autorizuar, sipas Vendimit të Asamblese, Keshillit Mbiqyres ose Keshillit të Administrimit, - sipas rastit,- për të përfaqësuar shoqërinë në kryerjen e transaksionit.

(b) Në rast se shoqëria nuk është regjistruar si aksionere e Emetuesit, atëherë do të kërkojnë dokumentat e shoqërisë, të nxjerra nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, me qëllim identifikimin e personit juridik si dhe personat që kanë kompetencë përfaqësimit të shoqërisë, në marrëdhënie me të tretet; Ekstrakti Historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

(c) si dhe në rast se do të shikohet e arsyeshme nga ana e Regjistrarit, do të kërkojnë për reflektimin e transaksionit, Vendimi i Asamblese apo i Keshillit Mbiqyres ose i Keshillit të Administrimit, që miraton kryerjen e një transaksioni të tillë.

(d) Në rastin e transaksioneve me objekt aksionet e një banke, duhet të paraqitet dhe miratimi paraprak me shkrim i Bankës së Shqipërisë, sipas ligjit „Për Bankat“ Nr.9662 date 18.12.2006

(e) Në rastin e Transaksioneve me objekt aksionet e një shoqërie sigurimi, duhet të paraqitet dhe miratimi paraprak me shkrim nga Autoriteti Mbiqyres Financiar, sipas ligjit Nr.9267 date 29.7.2004.

(f) Edhe në rastet e transaksioneve me objekt aksionet e shoqërive të tjera duhet miratimi paraprak me shkrim sipas dispozitave ligjore për funksionimin e këtyre shoqërive.

Koment: Aksionet që blihen nga shoqëria duhet të regjistrohen në emrin e shoqërisë dhe jo në emrin e punonjësit që kryen transaksionin. Për këtë arsye, Regjistrari duhet të sigurohet që ka të bëjë me një shoqëri dhe për llojin e saj (aksionare). Në rastin e aksioneve të Bankave respektohet kërkesa e ligjit „Për Bankat“.

Po kështu në rastin e aksioneve të shoqërive të sigurimit respektohen kërkesat e ligjit Nr.9267 date 29.07.2004.

Nqs Regjistruesi, me të dhënat që ka në dispozicion, nuk arrin të identifikojë shoqërinë, atëherë atij duhet t'i vihet në dispozicion dokumentacioni përkatës që vërteton regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit..

Nqs aksionet që do të shiten janë të regjistruara në emrin e një shoqërie aksionare për të cilën Regjistrari di apo ka arsye të besojë se nuk ekziston më, Regjistrari do të kërkojë garanci të mjaftueshme përpara se të procedojë me regjistrimin.

2.02 Transaksioni i kryer nga Administratori. Dokumentacioni i nevojshëm do të jetë po ai i pikës 2.01 vetëm se aprovimi jepet nga Administratori ndërsa vërtetimi do të bëhet nga maxhoranca e antarëve të Këshillit Mbiqyres.

2.03 Transferimi në llogarinë personale të punonjësit apo të Administratorit të shoqërisë. Nqs kërkojnë të kryhet një transferim i aksioneve të regjistruara në emrin e shoqërisë në llogarinë personale të një individi, për të cilin Regjistrari di ose ka arsye të besojë se është:

punonjës, transaksioni do të kryhet nqs paraqitet vërtetimi nga ana e Administratorit për rastin kur individi është punonjës .

Administrator ose anetar i Keshillit Mbiqyres ose i Keshillit të Administrimit, atëherë për kryerjen e transaksionit do të kërkojnë autorizimi paraprak nga Keshilli për miratimin e transaksionit.

2.04 Ndryshimi i emrit të shoqërisë. Nqs emri i shoqërisë ndryshon si rezultat i amendamenteve të bëra në aktet e saj të themelimit, apo si rezultat i bashkimit të saj me një shoqëri tjetër, aksionet e regjistruara në emrin e vjetër duhet të transferohen në emrin e ri në bazë të kërkesës zyrtare të shoqërisë drejtuar Regjistrarit Kjo kërkesë duhet të shoqërohet gjithashtu me vendimin përkatës të Qendres Kombëtare të Regjistrimit për regjistrimin e akteve.

2.05 Transaksionet për rastin e shoqërive të tjera (kolektive, komandite, me përgjegjësi të kufizuar, etj.).

Per kryerjen e transaksionit ne emer dhe per llogari te:

- shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, do te nenshkruaje administratori ose ne rast se jane me shume se nje administrator do te veprohet ne baze te klauzolave statutore, te cilat u referohen kompetencave te perfaqesimit te shoqerise ne marrredhenie me te tretet, nga te gjithë administratoret bashkerisht apo vetem nga njeri prej tyre.
- Shoqerise komandite ose kolektive, mund te nenshkruaje njeri nga ortakët e pakufizuar.

Gjithashtu do te kerkohet edhe vendimi I regjistrimit si person juridik I shoqerise, akti I themelimit, statuti dhe ekstrakti historik i Qendres Kombetare te Regjistrimit.

2.06 Transferimi në llogarinë personale të ortakut. Nqs kërkohet të kryhet një transferim i aksioneve të regjistruara në emrin e shoqërisë në llogarinë personale të një individi, për të cilin Regjistri di ose ka arsye të besojë se është njëri prej ortakëve ose administratori i shoqërisë, transaksioni do të kryhet nqs paraqitet edhe vendimi i asamblese se ortakeve per miratimin e transaksionit.

2.07 Ndryshimi i emrit të shoqërisë. Nqs emri i shoqërisë ndryshohet, aksionet e regjistruara në emrin e vjetër do të transferohen në emrin e ri në bazë të certifikates te leshuar nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

2.08 Transaksionet e kryera nga jo ortakët ose kur ortakët kanë vdekur. Nqs kërkohet të kryhet një transaksion me aksionet e regjistruara në emrin e shoqërisë dhe Regjistri di ose ka arsye të besojë se individi nuk është njëri prej ortakëve të shoqërisë apo që të gjithë ortakët e shoqërisë kanë vdekur atëhere kryerja e transaksionit kërkon:

- (a) prokurën e noterizuar të përfaqësimit të ortakëve nga ana e individit si dhe aprovimin e ortakëve (me nënshkrime të vërtetuara) për kryerjen e këtij transaksioni; ose
- (b) çertifikatën e vdekjes të të gjithë ortakëve plus
 - (i) aprovimin e ekzekutorit apo administratorit të ortakut që ka vdekur i fundit (me nënshkrim të vërtetuar), dhe
 - (ii) dokumentacionin që kërkohet në pikën 3.01.

SEKSIONI 3

KRYERJA E TRANSAKSIONEVE PER RASTIN E TRASHEGIMIT

3.01 Transaksioni nga Trashëgimlënësi tek Trashëgimtarët. Ky transaksion kërkon :

- (a) nqs trashëgimia është ligjore (pa testament),
 - (i) vendimin e gjykatës që përcakton trashëgimtarët dhe pjesët përkatëse takuese të tyre nga pasuria e trashëgimlënësit, dhe
 - (ii) dokumentin e identifikimit për sejcilin prej trashëgimtarëve; ose
- (b) nqs trashëgimia është me testament,

(i) vendimi gjyqesor per deshmine e trashgimise testamentare.

Koment: Ne rastin e trashgimise, qofte testamentare qofte ligjore, do te kerkohet deshmia e trashgimise, e cila presupozon verifikimn e ligjshmerise se testamentit, kufijte e disponimit te testaorit nepermjet tij, apo pavlefshmerine e tij .Per kete arsye do te kerkohet deshmia e trashgimise - vendim gjyqesor.

3.02 Transaksioni nga Trashëgimlënësi tek një person i tretë (jo trashëgimtar).

Kalimi i pronesise mbi aksionet, ne rastin kur ekziston nje vullnet i shprehur nga ana e trashgimelenseit me personin e trete (kontrate noteriale) dhe kur ne momentin e celjes se trashgimise ende nuk eshte bere reflektimi i kontrates ne regjistrin e aksioneve te Emetuesit, atehere nese do te shikohet e arsyeshme nga ana e Regjistrarit mund te kerkohet edhe:

(a) aprovimi i Ekzekutorit apo Kujdestarit

(b) Vendimin gjyqesor per caktimin e kujdestarit si dhe vendimin gjyqesor per trashgimise testamentare, sipas testamentit te noterizuar te trashgimlensesit ne te cilen percaktohet Ekzekutori per realizimin e vullnetit te testatorit; se bashku me deklaraten e Ekzekutorit per pranimin e obligimit testamentar

3.03 Transaksioni nga Ekzekutori ose Kujdestari tek një person i tretë (jo trashëgimtar).

Transaksioni ne lidhje me aksionet ne pronesi te trashgimelensesit mund te kryhet nga Ekzekutori ose Kujdestari vetem ne rastin:

(a) Vendimin e gjykates per miratimin e transaksionit

(b) aprovimin e Ekzekutorit apo te Kujdestarit

(c) Vendimin e gjykates per caktimin e Ekzekutorit apo Kujdestarit.

3.04 Transaksioni nga Ekzekutorët ose Kujdestarët. Në rastin kur Ekzekutori apo Kujdestari nuk është një person i vetëm, për kryerjen e transaksionit nevojitet aprovimi me nënshkrimin e vërtetuar të të gjithë Ekzekutorëve ose Kujdestarëve. Ne te dyja rastet qofte per Kujdestaret apo Ekzekutoret e pasurise trashgimore do te kerkohet edhe vendimi gjyqesor per miratimin e transaksionit.

Koment: Në rast se njëri nga Ekzekutorët ose Kujdestarët nuk gjëndet për të nënshkruar, nënshkrimi i tij i vërtetuar mund të zëvendësohet me një nga dokumentat e mëposhtëm:

- çertifikata e vdekjes
- vendimi i gjykatës për shpalljen e tij të vdekur
- vendimin e gjykatës për revokimin e cilësisë së Ekzekutorit ose Kujdestarit.

3.05 Transaksioni i aksioneve pronë e trashëgimlënësit por të regjistruar në një emër tjetër. Për këtë transaksion do të kërkohej i njëjti dokumentacion sipas rastit për pikat 3.01 ose 3.03 plus aprovimin me nënshkrim të vërtetuar të pronarit të regjistruar.

3.06 Transaksioni pas mbylljes së trashëgimisë. Kur aksionet, pjesë të një trashëgimie, zbulohen si të tilla pas ekzekutimit të testamentit, atehere per ndarjen e tyre do te veprohet, duke u bazuar tek vendimi gjyqesor, ku te jete percaktuar menyra e ndarjes se pasurise trashgimore.

3.07 E përgjithshme. Me termin Ekzekutor, në rregullat e këtij seksioni mund të nënkuptohen edhe vetë trashëgimtarët kur Trashëgimlënësi nuk ka caktuar një Ekzekutor të testamentit.

SEKSIONI 4

KRYERJA E TRANSAKSIONEVE PER RASTIN E MITURVE OSE TË PAAFTEVE

4.01 Transferimet në llogari të të miturve ose të të paaftëve. Për regjistrimin e aksioneve në llogari të të miturve ose të të paaftëve Regjistrari duhet t'i referohet Kujdestarëve përkatës.

Koment: Referimi tek Kujdestarët përkatës bëhet për arsye sepse të miturit ose të paaftët janë juridikisht të pa zotët për të vepruar.

4.02 Transferimi nga një person i tretë (shitësi) tek Kujdestari. Ky transaksion kërkon:

- (a) aprovimin e shitësit me nënshkrim të vërtetuar;
- (b) vendimin e gjykatës që cakton Kujdestarin, dhe
- (c) aprovimin e Kujdestarit me nënshkrim të vërtetuar.

4.03 Transferimi nga i mituri ose i paafti tek një person i tretë. Ky transaksion kërkon:

- (a) aprovimin nga Kujdestari me nënshkrim të vërtetuar;
- (b) vendimin e gjykatës për caktimin e Kujdestarit; dhe
- (c) vendimin e gjykatës që autorizon kryerjen e transaksionit.

4.04 Transaksioni nga Kujdestari tek i mituri ose i paafti që nuk është më i tillë. Ky transaksion kërkon:

- (a) aprovimin nga Kujdestari me nënshkrim të vërtetuar,
- (b) çertifikatën e lindjes për të miturin që nuk është më i tillë, ose çertifikatën e martesës për të miturën nën 18 vjeç, ose vendimin e gjykatës për njohjen e zotësisë juridike për të vepruar për të paaftin që nuk është më i tillë
- (c) aprovimin me nënshkrim të vërtetuar për kryerjen e transaksionit nga ana e të miturit ose të paaftit që nuk janë më të tillë.

4.05 Transaksioni nga Kujdestarët. Në rastin kur Kujdestari nuk është një person i vetëm, për kryerjen e transaksionit nevojitet aprovimi me nënshkrimin e vërtetuar të të gjithë Kujdestarëve.

Koment: Në rast se njëri nga Kujdestarët nuk gjendet për të nënshkruar, nënshkrimi i tij i vërtetuar mund të zëvendësohet me një nga dokumentat e mëposhtëm:

- çertifikata e vdekjes
- vendimi i gjykatës për shpalljen e tij të vdekur
- vendimin e gjykatës për revokimin e cilësisë së Kujdestarit.

4.06 E përgjithshme I. Të gjitha rregullat e mësipërme për veprimet që kryen nga Kujdestari i të miturit në moshën 14 - 18 vjeç bashkëngjitur me nënshkrimin e vërtetuar të Kujdestarit, kërkojnë edhe aprovimin e të miturit me nënshkrimin e tij të vërtetuar.

4.07 E përgjithshme II. Me cilësinë e kujdestarit njihet dhe prindi i të miturit. Në këtë rast, për të vërtetuar këtë cilësi do të nevojitet dokumentacioni i mëposhtëm:

- (a) çertifikatën e gjendjes familjare,
- (b) çertifikata e martesës; dhe
- (c) vendimi i gjykatës në rastin e zgjidhjes së martesës.

SEKSIONI 5

KRYERJA E TRANSAKSIONEVE ME PERFAQESUES

5.01 Transaksioni i kryer nga përfaqësuesi. Transaksioni kërkon:

- (a) Prokurën e përfaqësimit të noterizuar në të cilën tagret e përfaqësimit përfshijnë mundësinë e kryerjes së transaksionit; dhe
- (b) Aprovimin e përfaqësuesit me nënshkrim të vërtetuar.

Koment: Prokura mund të jete e pergjithsme ne te cilen nuk duhet te perjashtuar shprehimisht mundesia e perfaqesuesit per te disponuar mbi aksionet, ne pronesi te te perfaqesuarit, si dhe Prokura e Posacme, ne te cilen te jete parashikuar shprehimisht ne tagren e perfaqesuesit mundesia e kryerjes se veprimeve te ndryshme te tjetersimit me object – aksionet. (neni 71 K.C.)

5.02 Transaksioni i kryer nga disa përfaqësues. Nqs një person cakton disa përfaqësues, atëhere për kryerjen e transaksionit nevojitet i njëjti dokumentacion i pikës 5.01, vetëm se për aprovimin e pikës 5.01(b) duhet të nënshkruajnë që të gjithë përfaqësuesit.

Koment: Në rast se njëri nga përfaqësuesit nuk gjëndet për të nënshkruar, nënshkrimi i tij i vërtetuar mund të zëvendësohet me një nga dokumentat e mëposhtëm:

- çertifikata e vdekjes
- vendimi i gjykatës për shpalljen e tij të vdekur
- shfuqizimin e noterizuar të prokurës së përfaqësimit.

5.03 Transaksioni i kryer nga përfaqësuesi i ri. Ky transaksion kërkon:

- (a) Dokumentin që tregon mbarimin e prokurës për përfaqësuesin e vjetër, dmth njërin prej dokumentave të mëposhtëm:
 - Prokurën e vjetër të noterizuar me afat të skaduar
 - Çertifikatën e vdekjes të përfaqësuesit të vjetër
 - Vendimin e gjykatës për shpalljen e vdekur të përfaqësuesit të vjetër
 - Shfuqizimin e noterizuar, nga ana e të përfaqësuarit, të prokurës së përfaqësimit të përfaqësuesit të vjetër
 - Dokumentin e noterizuar, nga ana e përfaqësuesit të vjetër, të heqjes dorë nga përfaqësimi i të përfaqësuarit.
- (b) Prokurën e përfaqësimit të noterizuar për përfaqësuesin e ri, në të cilën tagret e përfaqësimit përfshijnë mundësinë e kryerjes së transaksionit; dhe
- (c) Aprovimin e përfaqësuesit me nënshkrim të vërtetuar.

5.04 Transaksioni i kryer nga zëvendësi i përfaqësuesit. Ky transaksion kërkon:

- (a) Prokurën e parë të përfaqësimit të noterizuar, në të cilën duhet të konfirmohet mundësia e përfaqësuesit për të caktuar një zëvendës;
- (b) Prokura e dytë e përfaqësimit të noterizuar, në të cilën tagret e përfaqësimit nga ana e zëvendësit të përfaqësuesit të mos tejkalojnë tagret që i përfaqësuari i ka dhënë përfaqësuesit në prokurën e parë, dhe
- (c) Aprovimin e zëvendësit të përfaqësuesit me nënshkrim të vërtetuar.

SEKSIONI 6

KRYERJA E TRANSAKSIONEVE PER RASTIN E LIKUIDIMIT APO TE FALIMENTIMIT

6.01 Transferimi nga likuidatori apo administratori i falimentimit tek një person i tretë. Ky transaksion kërkon:

- (a) Aprovimin me nënshkrim të vërtetuar nga ana e likuidatorit ose të administratorit të falimentimit;
- (b) Vendimin e gjykatës për caktimin e likuidatorit apo të administratorit të falimentimit; dhe
- (c) Aprovimin nga ana e gjykatës të transaksionit ose aprovimin e ortakëve me nënshkrime të vërtetuara për rastin e likuidatorit të caktuar nga ortakët.

Koment: Ky lloj transaksioni kur kryhet nga likuidatori i zgjedhur nga ortakët dhe transferon aksionet në llogari të njërit prej ortakëve të shoqërisë kolektive, të njërit prej ortakëve (të pakufizuar), të administratorit, të anëtarit të Këshillit Mbikqyrës, të anëtarit të Drejtorisë, të ekspertit kontabël ose të kontrollorit, duhet të aprovohet me vendim të Gjykatës ose me pëlqimin e të gjithë ortakëve.

Transferimi i aksioneve në llogarinë personale të likuiduesit, të administratorit të falimentimit apo të punonjësve, bashkëshortëve, paraardhësve ose pasardhësve të tyre ndalohet me ligj dhe nuk mund të kryhet nga Regjistrari.

6.02 Transferimi nga pronari i aksioneve në likuidim apo falimentim. Nqs Regjistrari di ose ka arsye të besojë se pronari i aksioneve ndodhet në gjëndje likuidimi ose falimentimi dhe aksionet që zotëron ai paraqiten për të kryer një transaksion, ato do të trajtohen si pjesë e masës së likuidimit ose të falimentimit. Në këtë rast, përveç aprovimit të pronarit me nënshkrim të vërtetuar, për kryerjen e transaksionit kërkohet edhe:

- (a) Dokumentacioni i pikës 6.01(b,c); dhe
- (b) Pohimin me nënshkrim të vërtetuar nga ana e likuidatorit ose të administratorit të falimentimit që aksionet nuk bëjnë pjesë në masën e likuidimit apo të falimentimit.

SEKSIONI 7

KRYERJA E TRANSAKSIONEVE PER RASTIN E BASHKEPRONESISE

7.01 Transaksioni i kryer nga bashkëpronarët. Kryerja e transaksionit mbi aksionet që janë në bashkëpronësi të dy ose më shumë pronarëve do të bëhet vetëm me aprovimin me nënshkrim të vërtetuar të të gjithë pronarëve, pavarësisht se dy ose më shumë prej tyre mund të jenë kryerësit e këtij transaksioni.

7.02 Kalimi nga pronësia në bashkëpronësi. Nqs pronari i aksioneve dëshëron të fusë dhe pjestarë të tjerë në pronësinë e tij, atëhere për të kryer këtë transaksion, Regjistrarit i nevojitet dokumentacioni i mëposhtëm:

- (a) Aprovimi zyrtar i Emetuesit, nqs ai ka vënë kufizime për këtë gjë ne statut; dhe
- (b) Nenshkrimin e vertetuar të të gjithë bashkëpronarëve të ardhshëm.
- (c) Dhenia e pelqimit nga zoteruesi i aksioneve të transferuara.

7.03 Kryerja e transaksionit me përfaqësues. Nqs të gjithë bashkëpronarët bien dakord, ata mund të caktojnë një përfaqësues për kryerjen e transaksioneve me aksionet e tyre. Në këtë rast veprohet sipas rregullave të seksionit 5.

7.04 Vdekja e njërit prej bashkëpronarëve. Kur njëri ose disa prej bashkëpronarëve vdes, trashëgimtarët e caktuar me vendim gjykate apo testament bëhen pjestarë në bashkëpronësi.

SEKSIONI 8

KRYERJA E TRANSAKSIONEVE PER RASTIN E KOMISIONEREVE TE BURSES

8.01 Moskryerja e transaksionit për personat e palicensuar. Nqs do të kërkohet kryerja e transaksioneve mbi bazën e një kontrate komision, Regjistrari do të refuzojë kryerjen e tij nqs kryerësit e transaksionit, edhe pse mund të kenë autorizimin e pronarit, nuk janë të pajisur me liçensë nga Autoriteti Mbikeqyres Financiar.

8.02 E përgjithshme. Rregullat për kryerjen e transaksioneve nga ana e komisionerëve të burses të liçensuar do të behen ne perputhje me dispozitat e ligjit „Per Titujt“

SEKSIONI 9

DHENIA E INFORMACIONIT DHE KONFIRMIMI I TIJ

9.01 Dhënia e informacionit. Çdo pronar aksionesh ka të drejtë të kërkoj informacion mbi llogarinë e tij të mbajtur nga Regjistrari, sa herë që ai e gjykon të nevojshme. Kërkimi i informacionit mund të bëhet me ose pa paraqitjen fizike të pronarit pranë Regjistrarit dhe duke kërkuar konfirmimin me shkrim ose jo nga ana e Regjistrarit për informacionin e dhënë.

9.02 Dhënia e informacionit me paraqitjen fizike të personit. Kur një person paraqitet fizikisht pranë Regjistruesit për të kërkuar informacion, ai duhet t'i paraqesë Regjistruesit dokumentacionin e mëposhtëm:

- (a) dokumentin e identifikimit të tij për rastin kur ai është vetë pronar i aksioneve, ose
- (b) dokumentin e identifikimit dhe dokumentacionin që vërteton cilësinë e tij si fiduçar i pronarit (shih seksionet përkatëse për kryerjen e transaksioneve); dhe
- (c) nënshkrimin e vërtetuar të tij.

9.03 Dhënia e informacionit pa paraqitjen fizike të personit. Kërkimi i informacionit mund të bëhet edhe me anë të mjeteve të komunikimit si: telefon, faks, postë, etj. Në këtë rast, për të bërë identifikimin e personit, Regjistruesit i nevojiten:

- (a) kur kërkimi i informacionit bëhet nëpërmjet telefonit nga pronari i aksioneve ose fiduçari i tij:

(i) emri atësia mbiemri

(ii) datëlindja dhe vendlindja

(iii) adresa e plotë

(iv) numri i dokumentit të identifikimit

(b) kur kërkimi i informacionit bëhet nëpërmjet faksit ose postës nga pronari i aksioneve ose fiduçari i tij:

(i) të njëjtat të dhëna si për rastin e telefonit: dhe

(ii) nënshkrimi i personit

9.04 Konfirmimi i informacionit. Aksioneri ose fiduçari i tij kanë të drejtë të kërkojnë nga Regjistruesi një konfirmim me shkrim të informacionit të dhënë. Konfirmimi me shkrim do të bëhet përkundrejt pagesës.

Koment: Kur aksioneri ose fiduçari i tij paraqiten fizikisht tek Regjistruesi për të kërkuar informacion dhe kërkojnë një konfirmim me shkrim të këtij informacioni, pagesa bëhet në momentin që lëshohet konfirmimi.

Kur aksioneri ose fiduçari i tij nuk paraqiten fizikisht tek Regjistruesi, dhe kërkimin e informacionit e kanë bërë nëpërmjet telefonit, në këtë rast Regjistruesi rezervon të drejtën për të mos dhënë konfirmim me shkrim.

Nqs kërkimi i informacionit bëhet nëpërmjet faksit ose postës, atëherë ai gjithmonë shoqërohet me një konfirmim me shkrim dhe si pasojë me pagesën përkatëse. Për këtë arsye kërkuesi i informacionit, dokumentacionit të pikës 9.03 (b), duhet t'i bashkangjisë dhe pagesën apo vërtetimin e pagesës në favor të Regjistruesit për konfirmimin që ky i fundit do të lëshojë.

SEKSIONI 10

NDRYSHIMI I INFORMACIONIT

10.01 Ndryshimi i informacionit. Çdo pronar aksionesh ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e informacionit që Regjistrari zotëron për të, sa herë që kjo gjë është e nevojshme. Ndryshimi i informacionit mund të bëhet me ose pa paraqitjen fizike të pronarit pranë Regjistrarit, por gjithmonë përkundrejt pagesës.

Koment: Me informacion, për qëllimin e rregullave të këtij seksioni, do të kuptojmë bashkësinë e të dhënave të mëposhtme:

- emri atësia mbiemri
- datëlindja dhe vendlindja
- adresa e plotë
- numri i dokumentit të identifikimit
- numri i telefonit apo faksit

10.02 Ndryshimi i informacionit me paraqitjen fizike të personit. Kur një person paraqitet fizikisht pranë Regjistruesit për të kërkuar ndryshimin e informacionit, ai duhet ti paraqesë Regjistruesit dokumentacionin e mëposhtëm:

- (a) për ndryshimin e adresës dhe të numrit të telefonit apo faksit, është e nevojshme vetëm kërkesa me nënshkrim të vërtetuar;
- (b) për ndryshimin e elementeve të tjerë, është i nevojshëm dokumenti i identifikimit ose vendimi i gjykatës.

10.03 Ndryshimi i informacionit pa paraqitjen fizike të personit. Ndryshimi i informacionit për këtë rast mund të bëhet vetëm me ane te postes. Nuk do të pranohen kërkesat për ndryshim informacioni të paraqitura me anë të telefonit apo faksit. Dokumentacioni që duhet ti paraqitet Regjistrarit është:

- (a) për ndryshimin e adresës dhe të numrit të telefonit apo faksit, është e nevojshme vetëm kërkesa e nënshkruar si dhe pagesa apo vërtetimi i pagesës në favor të Regjistruesit për shërbimin që ky i fundit do të kryejë;
- (b) për ndryshimin e elementeve të tjerë, përveç pagesës apo vërtetimit të pagesës në favor të Regjistruesit për shërbimin që ky i fundit do të kryejë, nevojitet:
 - (i) fotokopja e noterizuar e dokumentit të identifikimit; ose
 - (ii) vendimi i Gjykatës.
 - (iii)

SEKSIONI 11

KRYERJA E TRANSAKSIONEVE ME AKSIONE TE LISTUARA NE “BURSEN E TIRANES” SH.A.

11.01 Reflektimi i transaksioneve te kryera ne Bursen e Tiranes

Per reflektimin e transaksioneve me aksionet e listuara ne “Bursen e Tiranes” sh.a., do te veprohet vetem ne perputhje me dispozitat e ligjit “Per Titujt” dhe akteve nenligjore qe mund te dalin ne zbatim te ligjit “Per Titujt”.

Aprovuar nga Këshilli Mbikqyrës i Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve Sh.A.

**KRYETARI
(Ariana ÇELA)**

**ANETAR
(Zamir STEFANI)**

**ANETAR
(Valentina PINE)**

Tiranë, më _____ 2011.